

Vendim nr. 287 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ERMIRA MANELLI**, përfaqësuar nga avokat Olgert Manelli, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2215 (110), datë 13.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Ermira Manelli gëzon statusin e magjistratit prej datës 11.02.2020, kur ka filluar ushtrimin e detyrës së prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), mbështetur në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*), me vendimin nr. 92, datë 09.05.2023, ka hapur procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për 26 vende vakante (pozicione të lira) në disa prokurori pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, ndër të tjera, edhe një vend vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në procedurën për plotësimin e këtij vendi vakant kanë aplikuar kërkuesja dhe prokurori F.G. Ky i fundit gëzon statusin e magjistratit prej datës 12.07.2019, kur ka filluar ushtrimin e detyrës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

3. Fillimisht, me vendimin nr. 137, datë 07.06.2023, KLP-ja ka vendosur kualifikimin e të dy kandidatëve, duke vlerësuar se ata plotësonin kushtet ligjore të kandidimit. Nga ana tjetër, KLP-ja, me vendimet nr. 181 dhe nr. 182, datë 22.06.2023, ka refuzuar kërkesat e kandidatëve për vlerësimin e përsheptuar etik dhe profesional sipas ligjit nr. 96/2016.

4. Në vijim, duke konsideruar se të dy kandidatët nuk kishin, në fakt, asnjë vlerësim etik dhe profesional, KLP-ja ka realizuar renditjen e tyre bazuar në kriterin e renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës sipas nenit 43, pika 9, të lidhur me pikën 8, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016. Me vendimin nr. 197, datë 27.06.2023 (*vendimi nr. 197/2023*), për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, KLP-ja ka renditur të parën kërkuesen dhe të dytin kandidatin F.G. Mbështetur në këtë renditje, më pas, me vendimin nr. 240, datë 03.07.2023 (*vendimi nr. 240/2023*), KLP-ja ka caktuar kërkuesen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndërsa efektet e këtij vendimi fillonin në datën 01.10.2023.

5. Në datën 10.07.2023, duke mos qenë dakord me procedurën e ndjekur në dhënien e vendimeve të mësipërme, kandidati F.G. i është drejtuar gjykatës kompetente me padi për shfuqizimin e akteve administrative, vendimeve nr. 197/2023 dhe nr. 240/2023 të KLP-së. Në gjykim, krahas kësaj të fundit, si e paditur është thirrur edhe kërkuesja në cilësinë e personit të tretë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 58 (86-2023-811), datë 28.07.2023, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 197/2023 dhe nr. 240/2023 të KLP-së. Sipas gjykatës së apelit, në kuptim të nenit 43 të ligjit nr. 96/2016,

konkurrimi lejohet: së pari, ndërmjet kandidatëve, të cilët mund të renditen bazuar në dy vlerësime etike dhe profesionale (neni 43/7); së dyti, ndërmjet kandidatëve, të cilët mund të renditen bazuar në një vlerësim etik dhe profesional (neni 43/8); së treti, ndërmjet kandidatëve, të cilët, edhe pse nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional, mund të renditen sipas renditjes së tyre në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës (neni 43/9). Po sipas asaj gjykate, koncepti i pasjes ose jo të një ose dy vlerësimeve etike dhe profesionale nuk lidhet me pasjen *de facto* të një vlerësimi të tillë në momentin e aplikimit, por me mundësinë e pasjes së tij në kuptim të ligjit, sipas të cilit zhvillimi i karrierës bazohet në meritokraci dhe pikërisht në rezultatet e vlerësimit etik dhe profesional. Të kuptuarit ndryshe, sikurse KLP-ja në rastin konkret, do të bënte që zbatimimi në praktikë i nenit 43 të ligjit të ishte jo i drejtë, jo koherent dhe jo në përputhje me qëllimin e ligjit, për më tepër kur vlerësimi etik dhe profesional, ndërsa është përgjegjësi e KLP-së, është edhe e drejtë e kandidatit. Ritmi i veprimtarisë dhe punës së KLP-së ose koha që marrin vlerësimet etike dhe profesionale, ka vlerësuar ajo gjykatë, nuk mund të shërbejnë për arritjen në përfundime për pasjen ose jo të një ose dy vlerësimeve etike dhe profesionale për kandidatët aplikues. I njëjti kuptim për ligjin, sipas asaj gjykate, del edhe nga neni 17 i rregullores “Për procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”, e miratuar me vendimin nr. 261, datë 17.11.2020 të KLP-së.

7. Mbi kuptimin si më lart të ligjit, gjykata e apelit ka vlerësuar se paditësi F.G. i plotëson kushtet dhe ka mundësi të ketë një vlerësim etik dhe profesional në kuptim të ligjit, ndaj, në kushtet kur në kohën e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele dhe paraqitjes së aplikimeve mundësia ligjore e konkurrimin ndahet nga një vlerësim etik dhe profesional, të cilin paditësi mund ta ketë, ai konsiderohet si kandidat ligjor në kuadër të renditjes së kandidatëve në atë procedurë lëvizjeje paralele. Po sipas asaj gjykate, personi i tretë (kërkuesja) nuk mund të vijonte me konkurrimin në këtë procedurë, pasi, për shkak të ligjit, ai mund të vijonte vetëm për ata kandidatë që kanë mundësinë dhe potencialin juridik për të pasur një vlerësim etik dhe profesional. Nisur nga kjo, ka vlerësuar ajo gjykatë, procedura e ndjekur nga KLP-ja është prekur nga paligjshmëria që në momentin kur ka lejuar dhe konsideruar si kandidaturë të vlefshme juridikisht atë të personit të tretë (kërkueses), paligjshmëri e cila ka pasjellë me efekt domino paligjshmërinë e akteve të mëpasshme të asaj procedure lëvizjeje paralele. Sipas gjykatës së apelit, KLP-ja ka zhvilluar një procedurë konkurruese ndërmjet një kandidati, paditësit F.G., që ligji e lejon, dhe një aplikuesi, personit të tretë (kërkueses), të cilin ai nuk e konsideron më kandidat, për sa kohë nuk mund të kishte një vlerësim etik dhe profesional për shkak të mospasjes së tre vjetëve kalendarikë në detyrë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Po kështu, ajo ka paraqitur edhe kërkesë për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit. Një kërkesë e tillë është paraqitur edhe nga pala e paditur në procesin gjyqësor, KLP-ja.

8. Në lidhje me kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, me vendimet nr. 00-2024-961 dhe nr. 00-2024-962, datë 13.02.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tyre. Kurse në lidhje me rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2024-2215, datë 13.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve për shkelje ligjore, duke qenë të drejta përfundimet e saj në lidhje me qëllimin, kuptimin dhe zbatimin e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket fazave të procedurës së lëvizjes paralele dhe atyre të renditjes së kandidatëve, bazuar në kriterin e vlerësimit etik dhe profesional. Edhe sipas atij kolegji, në interpretimin sistematik dhe teleologjik të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, qëllimi dhe fryma e tij kërkon, në mënyrë taksative, që kandidatët të cilët kërkojnë zhvillimin e karrierës profesionale, t'u nënshtrohen procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, duke qenë pikërisht ky vlerësim një element thelbësor, përmes të cilit sigurohet respektimi i meritokracisë në zhvillimin e karrierës edhe në sistemin e prokurorisë, për sa kohë përmes saj identifikohet kandidati më i mirë. Po sipas atij kolegji, referuar nenit 84 të ligjit, për vlerësimin etik dhe profesional periodik të magjistratit çdo 3 ose 5 vjet, sikundër edhe nenit 97 të tij, për vlerësimin me procedurë të përsheptuar, rezulton qartë detyrimi i organit publik që përpara se të marrë vendim në lidhje me ngritjen në detyrë ose transferimin e kandidatit, të realizojë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve pjesëmarrës në procedurë, në mënyrë që vendimmarrjen përfundimtare ta mbështesë në rezultatet e vlerësimeve. Për rrjedhojë, sipas Kolegjit Administrativ, renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele duhet të bëhet bazuar në vlerësimet profesionale, numrin e tyre ose në mundësinë për t'i pasur ato dhe jo sikundër ka vepruar KLP-ja në rastin konkret, duke mos marrë parasysh një mundësinë të tillë vlerësimi. Një gjë e tillë, sipas atij kolegji, është në anashkalim të qëllimit të ligjit dhe krijon premisa për pabarazi mes kandidatëve, ndërsa vendos në të njëjtat pozita, si magjistratin që mund dhe duhet ta ketë një vlerësim profesional dhe që, për shkaqe të pavarura prej tij, nuk e ka atë, me ata magjistratë, të cilët nuk e kanë dhe as mund të kenë një vlerësim të tillë profesional. Për sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional, në kuptim të nenit 84 të ligjit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ajo gjen rregullim në rregulloren "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", të miratuar në zbatim të ligjit nga KLP-ja me vendimin nr. 95,

datë 09.05.2022, ku sipas nenit 6 të saj, periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

9. Në lidhje me rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit se paditësi F.G. i plotëson kriteret për të pasur një vlerësim profesional, ndërsa ka tre vjet kalendarikë në detyrë dhe, për pasojë, KLP-ja ka pasur detyrimin për vlerësimin e tij, sikurse vetë ajo ka vendosur me vendimin nr. 1, datë 16.01.2023, duke e përfshirë atë në rrethin e subjekteve, për të cilët, gjatë vitit 2023, do të kryhet vlerësimi periodik për periudhën e vlerësimit 2019-2021. Po kështu, ai kolegji e ka gjetur të drejtë edhe qëndrimin e gjykatës së apelit se personi i tretë (kërkuesja) ndodhej në kushtet kur nuk ka dhe as mund të ketë një vlerësim profesional, ndërsa nuk ka tre vjet kalendarikë në detyrë dhe, për pasojë, KLP-ja të kishte detyrimin për vlerësimin e tij, për sa kohë ka filluar detyrën në datën 11.02.2020 dhe dukshëm në momentin e aplikimit nuk e plotësonte këtë kusht ligjor. Për pasojë, sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, dy kandidaturat nuk mund të kandidonin së bashku në atë procedurë lëvizjeje paralele, ndaj lejimi dhe konsiderimi nga KLP-ja të personit të tretë si kandidaturë e vlefshme në kuadër të renditjes së kandidatëve ka çuar në paligjshmëri të procedurës, pasi ka zhvilluar një procedurë konkurruese ndërmjet një kandidati që ligji e lejon dhe një aplikuesi që ligji nuk e konsideron më kandidat.

10. Në datën 13.09.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.09.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

11. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje dhe nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimet me natyrë kushtetuese të kërkueses. Vetë trupi gjyqësor është ndarë në mendimin e tij për sa i përket afatit të vlerësimit. Gjykata e Lartë ka cituar faktet dhe ligjin e aplikueshëm, por nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit objekt gjykimi në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm. Vendimi i saj nuk përmban një analizë juridiko-ligjore, si dhe i mungon tërësisht arsytimi. Duke mos analizuar pretendimet e palëve dhe ligjin, Gjykata e Lartë ka kopjuar argumentet e gjykatës së apelit dhe ka konkluduar me vendim tërësisht të

paarsyetuar me bazë ligjore. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve në rekurs, ndërgjyqësinë, zbatimin e praktikës së KLP-së, faktin që kërkuesja nuk ka asnjë përgjegjësi se përse nuk është në proces vlerësimi edhe pse i plotëson vitet, kundërshtimi i akteve që nuk ishin pjesë e padisë ose afati i ngritjes së saj, Gjykata e Lartë duhet të jepte një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime.

11.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjyqtari S.N., i cili ka qenë anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, ishte në konflikt të hapur me bashkëshortin e kërkueses, njëkohësisht përfaqësues ligjor i saj. Ky i fundit ka qenë përfaqësuesi ligjor i palës paditëse që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore që lidhen me procedurën e ankandit për një pasuri të paluajtshme të ndodhur në qytetin e Vlorës, ku në cilësinë e palës së tretë në gjykim ka qenë edhe shtetasja L.N., bashkëshortja e gjyqtarit S.N., e cila ka marrë pjesë në ankandin e zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor, ku është përfaqësuar me prokurë nga vetë ai gjyqtar (bashkëshorti i saj). Madje në seancën gjyqësore të datës 31.05.2024, të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ka qenë i pranishëm vetë ky gjyqtar. Për rrjedhojë, gjyqtari S.N. ka pasur interes personal në blerjen e një pasurie që është në proces gjyqësor në gjykatën e apelit, mbi bazën e ankimit të bashkëshortit të kërkueses. Po kështu, bashkëshortja e gjyqtarit S.N. është edhe përfaqësuese e “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë, ku personat e përfaqësuar nga bashkëshorti i kërkueses kanë marrë kredinë, ashtu edhe fituesja e ankandit të pronës së tyre, çka përbën konflikt të hapur interesi, ndaj ky gjyqtar duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje. Ky gjyqtar i njëanshëm ka qenë gjyqtari në shumicë që ka vendosur për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

11.3. *Moszbatimit të drejtë të ligjit*, pasi Gjykata e Lartë i ka bërë një vlerësim të gabuar kuptimit të vitit kalendarik, duke vlerësuar se kërkuesja, në momentin e aplikimit për lëvizje paralele, ka pasur më pak se tre vjet kalendarikë vjetërsi pune, duke i llogaritur asaj vetëm periudhat janar-dhjetor të vitit 2021 dhe janar-dhjetor të vitit 2022, pa llogaritur periudhën shkurt-dhjetor të vitit 2020. Ndërkohë që nuk është mbajtur i njëjti standard me kandidatin tjetër, prokurorin F.G., i cili e ka filluar detyrën në korrik të vitit 2019 dhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar si periudhë vlerësimi vitet 2019-2021. Viti i parë i periudhës 3-vjeçare që i nënshtrohet vlerësimit është viti i emërimit dhe fillon në datën e emërimit. Momenti i emërimit të magjistratit në detyrë rrallëherë mund të përputhet me datën 1 janar, pasi ai

emërohet në detyrë pas mbarimit të Shkollës së Magjistraturës. Magjistrati duhet të vlerësohet për veprimtarinë që ka kryer çdo vit, duke përfshirë edhe vitin e emërimit, pavarësisht për sa kohë e ka kryer detyrën në një vit të caktuar, siç është vepruar edhe me paditësin F.G. Kërkuesja nga data 11.02.2020 e në vijim dhe në datën 09.05.2023, kur KLP-ja ka shpallur procedurën e lëvizjes paralele, kishte mbi 3 vjet vjetërsi në punë dhe kishte një periudhë 3-vjeçare që mund dhe duhej t'i nënshtrohej vlerësimit periodik nga KLP-ja. Ky është edhe qëndrimi që KLP-ja ka mbajtur për magjistratë të tjerë, duke përcaktuar si vit të parë vitin e emërimit dhe datë fillestare datën e emërimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë

paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 31, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, për kundërshtimin e procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi gjyqtari S.N., anëtar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e kërkueses, ka qenë në konflikt interesi, për shkak se bashkëshortja e tij ka qenë palë në një proces gjyqësor ku përfaqësues ligjor i palës paditëse ka qenë bashkëshorti i kërkueses, që është edhe përfaqësuesi ligjor i kësaj të fundit.

16. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se shtetasit S.I. dhe D.I. kanë kundërshtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë veprimet përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor që lidhen me zhvillimin e ankandit për një pasuri të paluajtshme, të ndodhur në qytetin e Vlorës, të vendosur prej tyre si garanci hipotekare për marrjen e një kredie pranë “Raiffeisen Bank” sh.a. Në këtë proces paditësit janë përfaqësuar edhe nga avokati O.M., bashkëshorti i kërkueses dhe përfaqësuesi i saj përpara kësaj Gjykate. Në atë gjykim rezulton të ketë marrë pjesë, në cilësinë e personit të tretë, edhe shtetasja L.N., e cila është ofertuese në ankandin e zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor dhe sipas procesverbalit të datës 30.06.2023 për zhvillimin e ankandit të dytë, ajo është përfaqësuar nga bashkëshorti i saj S.N. Kolegji vëren, gjithashtu, referuar të dhënave të vendimit të paraqitur bashkëlidhur kërkesës, se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në datën 07.08.2023, kurse vendimi i asaj gjykate është dhënë në datën 27.06.2024, ku është vendosur rrëzimi i padisë. Për sa u përket të dhënave të çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë, referuar atyre të publikuara në faqen zyrtare të asaj gjykate, rezulton se trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e rekursit të kërkueses, ku bën pjesë edhe gjyqtari S.N., është shpallur në datën 29.02.2024. Po kështu, rezulton se e njëjti trup gjykues, në të cilin bën pjesë edhe gjyqtari S.N., ka marrë në shqyrtim edhe kërkesat e paraqitura nga kërkuesja dhe KLGJ-ja për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, për të cilat Gjykata e Lartë ka disponuar me vendimet e datës 13.02.2024.

17. Në vështrim të fakteve si më sipër, Kolegji vlerëson se në momentin kur është njohur me përbërjen e trupit gjykues që do shqyrtonte çështjen e saj në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka qenë në dijeni të ekzistencës së shkakut të pretenduar për paanshmërinë e gjyqtarit S.N. Megjithatë, edhe pse i kishte të gjitha mundësitë procedurale që ofron legjislacioni në fuqi

për të kërkuar përjashtimin e atij gjyqtari, në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të neneve 72 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, kërkesja nuk i ka përdorur ato. Vetë kërkesja nuk ka parashtruar në ankimin kushtetues individual se kur ka marrë djeni efektivisht për përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ose momentin se kur është njohur me vendimet për rrëzimin e kërkesës për pezullim, apo për pamundësinë e saj për të kërkuar në atë gjykatë përjashtimin e gjyqtarit S.N. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesja, edhe pse ka pasur mjete efektive në dispozicion, nuk i ka shtuar ato, ndaj në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të cilin kërkesja e ka ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual, konsiderohet se nuk ka shtuar mjetet juridike efektive, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuases, për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 13.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 13.09.2024. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë, rezulton se vendimi i asaj gjykate është publikuar në faqen zyrtare në datën 24.05.2024, e cila konsiderohet si data në të cilën kërkesja ka marrë djeni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë, pra data nga e cila fillon të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë kërkesja legjitimohet *ratione temporis*.

20. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje dhe nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimet e saj me natyrë kushtetuese, si dhe nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit objekt gjykimi në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm. Sipas kërkuases, vendimi nuk përmban një analizë juridiko-ligjore, si dhe i mungon tërësisht arsyetimi dhe duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve në rekurs, ndërgjyqësinë, zbatimin e praktikës së KLP-së, faktin që kërkesja nuk ka asnjë përgjegjësi se përse nuk është në proces vlerësimi edhe pse i plotëson vitet, kundërshtimin e akteve që nuk ishin pjesë e padisë ose afati i ngritjes së saj, Gjykata e Lartë duhet të jepte një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime. Po sipas kërkuases, ka pasur moszbatim të drejtë të ligjit, pasi Gjykata e Lartë i ka bërë një vlerësim të gabuar kuptimit të vitit kalendarik, duke vlerësuar se kërkesja në momentin e aplikimit për lëvizje paralele ka pasur më pak se tre vjet kalendarikë vjetërsi pune, pra duke i llogaritur asaj

vetëm periudhat janar-dhjetor të vitit 2021 dhe janar-dhjetor të vitit 2022, pa llogaritur periudhën shkurt-dhjetor të vitit 2020, ndërkohë që nuk është mbajtur i njëjti standard me kandidatin tjetër, prokurorin F.G., i cili e ka filluar detyrën në korrik të vitit 2019 dhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar si periudhë vlerësimi vitet 2019-2021. Kërkuësja ka pretenduar se nga data 11.02.2020 e në vijim dhe në datën 09.05.2023, kur KLP-ja ka shpallur procedurën e lëvizjes paralele, ajo kishte mbi 3 vjet vjetërsi në punë dhe kishte një periudhë 3-vjeçare që mund dhe duhej t'i nënshtrohej vlerësimit periodik nga KLP-ja, qëndrim që kjo e fundit e ka mbajtur për magistratë të tjerë, duke përcaktuar si vit të parë vitin e emërimit dhe datë fillestare datën e emërimit.

21. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji, referuar argumenteve të parashtruara nga kërkuësja në mbështetje të pretendimeve të saj, vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave, interpretimit të ligjit dhe përcaktimit të fakteve dhe, si të tilla, duke qenë pretendime me natyrë thellësisht ligjore nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Kolegji vëren, po kështu, se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuëses i kanë dhënë përgjigje asaj në lidhje me bazueshmërinë e këtyre pretendimeve, duke interpretuar edhe ligjin e zbatueshëm në rastin konkret në drejtim të fazave të procedurës së lëvizjes paralele dhe asaj të renditjes së kandidatëve, bazuar në kriterin e vlerësimit etik dhe profesional, përveç edhe për sa i përket periudhës së këtij vlerësimi. Për rrjedhojë, jo vetëm që pretendimet e ngritura nga kërkuësja përgjatë procesit gjyqësor rezultojnë t'i jenë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe të kenë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e zakonshme në përputhje me kompetencat e tyre, por, nga ana tjetër, ky arsyetim nuk rezultojnë

të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë ose që të mos respektojë standardet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar.

23. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se për sa kohë kërkuessa nuk ka parashtruar argumente kushtetuese për të mbështetur pretendimet e saj në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar, ajo nuk legjitimohet *ratione materiae* për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.